

# SHPJEGIMET E KOLEC TOPALLIT PËR THEKSIN NË GJUHËN SHQIPE

Hana RADONIQI

Universiteti i Gjakovës „Fehmi Agani“, Fakulteti i Filologjisë, Gjuhë dhe Letërsi Shqipe

radoniqihana@gmail.com

UDC 811.18'342.81

*Conference paper*

## Abstract

The aim of this paper is the treatment of Albanistic studies, in which Kolec Topalli presented and summarized the historical issues of the Albanian accent. His monographic studies have become frequent after the 1980s, especially after the publication of study “The accent in the Albanian language” (1995). The analysis of the Albanian accent according to Topalli’s views is divided into two parts: the accent of the word and of the sentence.

In addition to these, the research is based on the author’s work on the movement of the Albanian accent, which is called *themechanic regulation of the accent*. Although other linguists have thought that the place of the accent in the Albanian words cannot be presented with a general rule (Dodi 1970, 2004), or can rely on the rules, constraints (Optimality Theory) and other principles, however Topalli’s contribution in the field of Albanian accent history has brought valuable data.

**Key words:** *Accent, syllable, quantity, vowels, dynamic.*

## Përmbledhje

Synimi i punimit është trajtimi i studimeve albanistike, në të cilat Kolec Topalli ka paraqitur e përmbledhur çështjet historike të theksit të shqipes. Studimet monografike të tij janë shpeshtësuar pas viteve ‘80, në veçanti pas botimit të veprës “Theksi në gjuhën shqipe” (1995). Analiza e theksit të shqipes sipas pikëpamjeve të Topallit ndahet në dy pjesë: theksi i fjalës dhe i fjalisë.

Përveç këtyre, hulumtimi mbështetet në trajtesat e autorit për lëvizjen e theksit të shqipes, e cila është quajtur *rregullim mekanik i theksit*. Ndonëse, gjuhëtarë të tjerë kanë menduar se vendi i theksit në fjalët e shqipes nuk mund të paraqitet me një rregull të përgjithshme (Dodi 1970, 2004), ose se mbështetet te rregullat, kufizimet (Teoria e Optimalitetit) e të tjera parime, prapëseprapë ndihmesa e Topallit në fushën e historisë së theksit në shqipen ka sjellë të dhëna të vlershme.

**Fjalët kyçe:** *Theks, rrokje, kuantitet, zanore, dinamik.*

## 1. Theksi i fjalës

Topalli, sipas mënyrës me të cilën bëhet dallimi i rrokjes së theksuar për nga fuqia e shqiptimit, që në hyrje të monografisë ia jep theksit të shqipes atributin *dinamik/ intensiv* (edhe *ekspirator*)<sup>1</sup>; ndërkaq, sipas vendit që merr në fjalë, ajo ka theks *të ngulët (të palëvizshëm)* në paradigmat e eptimit: të ngulitur në rrënjë të fjalës. Në anën tjetër, zanoret i cilëson sipas gjatësisë (kuantitetit) në fjalë, si përbërësen që luan rol në realizimin e theksit e që shqipja, siç ka supozuar Topalli, priret t'i theksojë zanoret parafundore, duke krijuar fjalë me ritëm trokaik,<sup>2</sup> si: it. *máccchina* > shq. *makínë*, sll. *lędina* > shq. *lëndínë*. Kjo lëvizje është quajtur *rregullim mekanik i theksit*.

Sidoqoftë, studimin e tij e ka përqendruar fillimisht në periudhën parahistorike, duke shpjeguar se shqipja – në shekujt e parë të erës sonë – ka pasur theksim nistor sikurse ilirishtja; po kështu, edhe grupi i gjuhëve indoevropiane: protogjermanishtja, gjuhët italice, keltishtja etj. Por, duke u mbështetur në radhën kohore, mbase duke filluar me shek. III e IV të erës sonë, shqipja në periudhën e marrëdhënieve me latinishten e ndërron vendin e theksit në rrokjen parafundore që, nënkupton se, ky proces ishte kryer para kontakteve me sllavishten.<sup>3</sup>

Tutje kësaj, dukuria e ngulitjes së theksit në një rrokje ose mbi zanoren fundore të temës – pra, jo në mbaresat rasore e vetore, prapashtesat e shumësit, nyjat shquese etj. – është treguar më e fuqishme, sesa prirja për theksim parafundor, ta zëmë *lúleve, páskemi, ndëshemi*. Kurse, sipas Demirajt, karakteri dinamik i theksit të shqipes është më i hershëm, se ai i ngulitjes së theksit mbi një rrokje të caktuar të temës dhe se, theksimi i rrokjes fundore të temës te folja, është përfutur menjëherë pas shfaqjes së prirjes për të mos e vendosur më theksin mbi ndonjë mbaresë vetore (1988: 61–66).

---

<sup>1</sup> Shih te *Fonetika e gjuhës së sotme shqipe*. Sipas Dodit (1970: 98), theksi dinamik nuk mund të quhet theks ekspirator, meqë forcimi i tingullit nuk lidhet me forcimin e nxjerrjes së rrymës së ajrit. Pra, forcimi i zanores lidhet me shtimin e tensionit të kordave zanore që sjell ngushtimin e hapësirës midis kordave dhe dobësimin e rrymës së ajrit.

<sup>2</sup> Shih te *Comparative Indo-European linguistics: an introduction*. Siç e ka quajtur Beekes-i “aksentin” e gjuhëve indoevropiane (2011: 154). Sipas tij, shqipja vë theksin në rrokjen e fundit te temat foljore dhe te parafjalët; ndërsa, emrat, shpeshherë kanë theks parafundor.

<sup>3</sup> Shih te *A grammar of modern Indo-European*. Në bazë të Quiles-it, theksi i dëshmuar i dialekteve indoevropiane paraqet një larmi të madhe: gjermanishtja dhe irlandishtja e vjetër kanë theksuar rrokjen e parë, sllavishtja dhe greqishtja kanë pasur një aksent “gjysmë të lirë”, latinishtja dhe armenishtja (si shqipja) kanë theksuar rrokjen parafundore etj. (2007: 94).

Edhe Bokshi (2008: 93–94), duke e përkrahur mendimin e W. Meyer-Lübke-s, ka vërtetuar se në kuadër të rindërtimit të zhvillimit të sistemit të temave emërore është imponuar të përfundohet se protoshqipja e kishte krijuar theksin dinamik shumë kohë para huazimeve nga greqishtja e vjetër e nga latinishtja – para shek. III para e. re. Kështu, përfitimi i theksit dinamik në shqipen del të jetë i kohës parahistorike, pra edhe më i lashtë se ç’ka menduar W. Meyer-Lübke-ja (Bokshi 2010: 11). Sipas tij, theksi dinamik është faktori i ndryshimeve të mëdha që pësoi fundi i fjalëve, duke përmbledhur edhe elementet fleksive.

Ndryshe, Bokshi (2005: 203) nuk e përkrah mendimin e N. Jokl-it, sipas të cilit ky proces ka ndodhur në kohën e huazimeve latine. Për më tepër, në bazë të trajtimeve të Topallit, vendi i theksit varet edhe nga cilësia e zanores, për arsye se zanoren e patheksuar -ë- e vlerëson si zanore që nuk formon rrokje theksmbajtëse: *dímër*. Për të përmbledhur, në po të njëjtin vit me veprën “Theksi në gjuhën shqipe”, më 1995 në sesionin shkencor me temë “Gjon Bukuzu dhe tradita e shkrimit të shqipes”, Topalli ka paraqitur të dhëna për sistemin vokalik të shqipes, karakteristikë e së cilës është rënia e një zanoreje, e cila është jashtë theksit të fjalës.<sup>4</sup>

Sidoqoftë, burim hulumtimi për këtë dukuri mbetet vepra e parë e shkruar në shqip, “Meshari” i Buzukut (në gjysmën e dytë të shek. XVI), edhe pse procesi i rënies së tingujve (sidomos në fund fjale) ka nisur para dokumentimit të kësaj veprë. Autori ka shqyrtuar rënien e zanores -ë- në fund fjale, ku fjalët me ritëm daktilik janë kthyer në fjalë me ritëm trokaik: *njêrzet, ungjillit, ɳ Farizejshit*<sup>5</sup> (Topalli 1995b, 2012). Domethënë, nga fjalët ku rrokja e theksuar nistore ndiqet nga dy rrokje të tjera të patheksuara (– U U), në fjalë ku rrokja e theksuar ndiqet nga një rrokje tjetër e patheksuar (– U) ose, nga theksi që bie tej fundit të rrokjes – *njêrzetë* – në theks që bie në rrokjen e parafundit – *njêrzet* – dhe që dëshmon se theksi lëviz nga përpara në drejtim të mbaresës.

Sipas parimit fonetik, nuk arrihet një shpjegim i saktë në lidhje me këtë dukuri, meqë kjo -ë- në disa rrethana ruhet (*ujënatë, të mitunënë, tue mbëljedhunë, shkushulluomenë, vetëvetëhenë, të lutunatë*), e në disa bie (*d verbënet, t shurdhënet, ɳ së dalët së diellët djerie*

<sup>4</sup> Zanoret e patheksuara -ë dhe -e janë tinguj të trashëguar, kurse -i, -u, -a, -o formime të brendshme të gjuhës. Kurse, rëniet e zanoreve mund të jenë: në fund (elizioni), në ballë/ nistore (afereza) dhe në trup të fjalës (sinkopa) – tipike për gjuhën e folur.

<sup>5</sup> Shenja diakritike e sonantes *ɳ* paraqet vlerën e saj silabike – pra, aftësinë rrokjeformuese (për arsye se me anë të elizionit është hequr zanorja *ë*), duke formuar rrokje pa ndihmën e zanoreve. Përveç kësaj, janë edhe sonantet e tjera *ɳ, r, l*. Sot, sonantet me vlerë silabike shënohen *ɳ, ɳ, r, l*, kurse rënien e një tingulli ose të një rrokjeje e shënojmë me apostrof (!) që simbolizon tingullin *zero fonologjik*.

*mbe e ndjenjunit, popullit tit*); pra, bie te emrat mashkullorë për shkak të largësisë së ë-së nga theksi i fjalës. Kurse, sipas parimit morfologjik kjo zanore ka rënë vetëm tek emrat mashkullorë, por është ruajtur tek emrat femërorë (*ndë bark të peshkut, të ndhezunitë e shpirtit sit, dhentë e përintit tyne, por përpara faqesë sate, farësë saj, festësë xhudhivet*); pra, ruhet te femërorët për ta ruajtur të pandryshuar trajtën e nyjës së prapme.

Kështu që, modeli i trajtës gramatikore që merr emri femëror gjatë lakimit, të jetë njësoj, si: *dhi-së, fe-së, gjind-së, fushë-së, lule-së*. Kurse, sot për këtë gjini kemi tri versione të mbaresave -ës, -s, -së. Ndërkaq, edhe emri *qytet-së (qytetja)* përfshihet në këtë grup, duke pasur parasysh se ka qenë emër i gjinisë femërore, por që në shekujt e fundit ka kaluar në gjininë mashkullore.

Duke dhënë vrojtime për zhvillimet e mëhershme, interes përbëjnë edhe prapashtesat e theksuara me burim latin që krijojnë fjalë të reja: -ar (kafshar), -atë (lajthatë), -eshë (bareshë), -et (kallmet), -el (cungel), -iq (koshiq), -oll (kunatoll), -onjë (ulkonjë), -oq (marroq), -tyrë (shembëlltyrë), -uc (derkuc), -ucë (birucë), -uk (balluk), -ul (kaçul), -ulë (gërbulë), -yrë (kalbtyrë) etj.; përkundrazi, sipas autorit, nga greqishtja e vjetër s'ka hyrë asnjë prapashtesë. Pastaj, ato me rrokje të mbyllura sllave: -ac (tullac), -aç (thumbaç), -al (cungal), -ash (gjumash), -ec (burrec), -iç (barkiç), -ik (rrasik), -man (çalaman), -nik (drithnik), -osh (gjelosh) etj.; por edhe: -ajkë (këmbajkë), -icë (tulicë), -inë (luginë), -ishtë (ahishtë), -otë (lapotë), -utë (gëzhutë).

Veç këtyre, edhe ato greke: -at (konispolat), -jat (vlonjat), -it (zagorit), -os (qeros), -jot (himarjot) etj.; por edhe -omë. Së fundi, turke: -llëk/ -llok, -qar etj. (shih te *Theksi në gjuhën shqipe*). Në rastin e kundërt, sipas Demirajt (1988: 67), prapashtesat që nuk e tërheqin theksin mbi vete, janë: -më (ndihmë), -je (lindje), (-ë)s (shkundës), -t(ë) (i ftohtë), -(ë)m(ë) (i mesëm), -shëm (i ndershëm), -z(ë) (breshkëzë), -lë (zogëlë), -çe (nipçe), -kë (shqerkë), -ko (dajko) etj.

Më pas, Topalli, e ka përqendruar studimin edhe në kuantitetin e zanoreve të theksuara e, siç ka shtuar, kjo dukuri lidhet ngushtë me theksin dinamik<sup>6</sup>. Autori, shpjegimin e theksit e lidh edhe me gjeografinë dialektore, **kuantiteti** varion ndërmjet dialekteve, por edhe nga faktorët morfologjikë e sintaksorë – këto të fundit i trajton edhe në kuadër të fonetikës sintaksore a të sand'hit (bashkimi i dy fjalëve ose i formave të fjalës, duke rezultuar në

<sup>6</sup> Shih te *Theksi në shqipen*. Sawicka (1988: 113–117) në bazë të kërkimeve eksperimentale për theksin e shqipes, ka vërtetuar se intensiteti dhe lartësia (toni themelor) nuk luajnë rol në formimin e theksit dhe se, theksi i shqipes, nuk ka karakter dinamik. Sipas saj, gjatësia e zanoreve është faktor relevant në formimin e theksit – shqipen e ka vlerësuar me theks kuantitativ. Për të kundërtën, shih *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe* (Dodi 2004).

ndryshimet sistematike fonologjike) – në zhvillimin e tij historik. Ndërkaq, sipas përndarjes kuantitative të gjatësive të zanoreve, si rezultat i rënies së mbaresave të vjetra të trashëguara dhe, në kuadrin e huazimeve ku rol të rëndësishëm luan analogjia, kemi:

- **zanore të shkurtra** në rrokje fundore të mbyllura: *mik, im, kam, mjaft, kap, ish* (veta III njëjës), *vdiq, hidh* (mënyra urdhërore) dhe *shkofsh*; por edhe, në rrokje fundore të hapura: *baba, ti, se, një, ha* (veta II, III njëjës), *dha, shko, ende, te*; dhe, në rrokje jofundore: *hape, vishu, miqve*;

- **zanore të mesme**<sup>7</sup> në fjalët me theks jofundor: *pushë, e madhe, mua, katër, është, sipër, dua* (e tashmja), *shkonte, shkova, eja* (mënyra urdhërore), *të hapë, hapkam, qofsha* dhe *pasë, pasur, qenë, thatë, larë* (format e pjesores) dhe,

- **zanore të gjata** në rrokje fundore të hapura: *thi, e ve, ne, dy, ra, mbi, u la, ble* (pjesore e shkurtër), *ha* (veta I njëjës); në rrokje të mbyllura: *det, yll, gur, blej, të jem* (Topalli 1995a: 77–80). Ndërkaq, Çabej (1987: 119) ka dhënë po ashtu tri lloj vokalesh/ rrokjesh: *vëllā* (e gjatë), *lopë* (e mesme) dhe *ata* (e shkurtër), por pa i përcaktuar më tej.

Në bazë të këtyre të dhënave, vërehet se gjatësia e mesme e zanoreve të theksuara ka dalë vetëm në pozicion jofundor; por, edhe për nga ana e ngjashmërisë afrohen më shumë me të gjatat, sesa me të shkurtrat.<sup>8</sup>Psh., nga një matje josistematike që kemi bërë për përndarjen e fonemave, folësi i cili ka lindur në Gjakovë, por që banon në Tiranë, ka shqiptuar parafjalën përballë /pərba:ɫ/, kurse folësja e cila ka lindur në Tiranë dhe banon po ashtu atje, e ka shqiptuar /pərbaːɫ/. Pra, i pari me zanoren **a** të gjatë fundore, ndërsa e dyta të njëjtën fjalë me zanore të mesme.

Meqë i kryen dy funksione, pra mund të dalë si ndajfolje dhe si parafjalë, Topalli ka shprehur se si ndajfolje, kjo fjalë ka kuantitet të mesëm, për arsye se del në rrokje parafundore. Sipas nesh, edhe në funksionin e parafjalës del në rrokje parafundore, kështu që në këtë rast, kuantiteti mund të varet nga rrethimi i dyfishtë brenda fjalisë: ose është në fund të saj (si ndajfolje *I doli përballë*), ose në mes të saj + një grup emëror (si parafjalë *Shqipëria u gjend përballë një sërë pengesash*).

Pas shënimeve të tjera për kuantitetin e zanoreve të theksuara tek emrat e mbiemrat, autori ka konstatuar se rënia e zanores -ë ndikon edhe në humbjen e rrokjeve: kalimi i fjalës nga parafundore në fundore: *punë>pūn, i mirë>i mīr* etj.; ngjashëm ka ndodhur edhe në

<sup>7</sup> Zanoret e gjatësisë së mesme janë kryesisht emra me mbaresën -ë psh., e trokeut *banjë, sitë* ose e amfibrakut *kërqelë, koritë*.

<sup>8</sup> Shih te *Artikuj mbi gjuhën shqipe*. Më gjerësisht, artikullin: Grafia e Buzukut dhe disa çështje të sistemit fonetik të shqipes (Ismajli 1987 : 105–146).

sistemin foljor, në dialektin e Veriut, karakterin e rrokjes në kuadrin e theksit e ka lidhur me rënien e mbaresës -ë te pjesoret, si *lūt, prēk* etj.; kurse, si pjesoret e shkurtra *nxē, prē* me zanore të gjatë, e ka lidhur me shkakun se gjenden në rrokje të hapura – të gjitha këto, të trajtuara si krijime të periudhës postetnike të gjuhës, si zhvillime të brendshme të saj. Nga kjo rregull përjashtohet ndajfolja *shumë>shum* me zanore të shkurtër e që, duhet të dilte me zanore të gjatë. Por, si rezultat i kësaj është pozicioni i patheksuar i saj në fjali (sand'hi) që krijon shkallën sipërore, psh. *shumë i madh, shumë shpejt*.

Pas këtyre hulumtimeve, në vitin 2000, në sesionin shkencor “Shqipja 2000” të Seminarit, Topalli ka shpalosur zhvillimin e rrëgjimit të zanoreve, i shkaktuar nga theksi dinamik – dukuria e theksimit të fjalëve ka vepruar në mijëvjeçarin I të erës së re, para depërtimit në masë të sllavizmave (shek. IX–X). Kah fundi i këtij mijëvjeçari, shuhet dukuria e theksimit, shndërrimet /s/ > /sh/ dhe /l/ > /ll/, rotacizmi, metafoia etj., për të hyrë në mijëvjeçarin II dhe për t'i shqyrtuar dukuritë e trashëguara nga gjuha-nënë (theksi dinamik dhe kuantiteti) dhe ato që janë zhvilluar brenda shqipes (rrëgjimi e rënia e zanoreve të patheksuara dhe lëvizja e theksit sipas rregullimit mekanik).

Për të vazhduar tutje, autori ka shtuar se:

- gjuha shqipe ka pasur theksim nistor, përkundrajt prirjes së mëvonshme për theksim parafundor (shih edhe te *Studime gjuhësore III*);

- duke e zhvendosur theksin në zanoren e fundit të temës, zanorja /ë/ është rrëgjuar dhe e ka humbur aftësinë e të theksuarit;

- sistemi i ri i kuantitetit të zanoreve, i ndikuar nga faktori analogjik (morfologjik) dhe nga ai i fonetikës sintaksore – sand'hi (sintaksor). Sipas faktorit të parë, gjatësitë e ndryshme të zanoreve të një forme të caktuar janë shtrirë në trajta të tjera paradigmatiche; sipas faktorit të dytë kemi shkurtime të zanoreve të gjata, ku fjalët në ligjërimin e lidhur kanë hyrë në marrëdhënie të ngushta, duke krijuar grupe fjalësh (sintagma) me një theks të vetëm;

- rënia e tingujve që kanë qenë jashtë theksit të fjalës, në pozicion paratheksor zanoret janë ruajtur, kur fjala përbëhet prej dy rrokjesh paratheksore. Pra, rrëgjimin më të fortë e ka pësuar zanorja që ishte më pranë theksit (kështu, bie poshtë mendimi se sa më larg theksit të fjalës që ndodhen zanoret, aq më tepër i janë nënshtruar rrëgjimit) etj. (Topalli 2001: 389–399).

Më tej, te zanoret e patheksuara nistore merret me etimologjinë e tyre, pa i lidhur në rrafshin rrokjesor a theksor; te zanoret paratheksore në trup të fjalës (fjalët me dy rrokje paratheksore) ka përmendur se zanorja që bie më shumë është ajo më pranë theksit, sesa zanorja e ballit të fjalës, duke kaluar kështu në modelin me një rrokje të patheksuar, psh. lat.

*sanitātem*>*shëndet*, lat. *potestātem*>*pushtet*, lat. *incarcāre*>*ngarkoj* etj., ndërsa pjesa tjetër e trajtimeve merret me zhvillimet e ndryshimeve të zanoreve të patheksuara në shqipen, pa ndonjë trajtesë ku përfshihet edhe theksi; te zanoret pastheksore në trup të fjalës është fokusuar te kthimi i tyre në tingullin *-ë/-* shndërrimi i tij në një zanore tjetër, psh. lat. *fēmina*>*femër* dhe, në periudhën e shqipes letrare, lat. *saeculum*>*shekëll*>*shekull* etj.; dhe, si zanore të patheksuara fundore të shqipes së sotme ka renditur *-ë, -e, -i, -u, -a, -o* – pra, mungon vetëm *-y*-ja në këtë pozicion – që shqipja i ka zhdukur që herët, për shkak të theksit të fuqishëm dinamik.

Mbi të gjitha, Topalli është shprehur për zanoren *-ë*, duke përmbledhur se ky tingull ka më shumë vlerë grafike, sesa shqiptimore: kështu, nga fjalët me ritëm trokaik*fishë*, rënia e zanores fundore *-ë* ka krijuar fjalë njërrrokëshe me zanore të gjatë *fūsh*. Në rastin e zanores *-e*, autori duke u mbështetur edhe në studimet e Sh. Demirajt, ka vërtetuar se kjo mbaresë (*maleve*) nuk ka qenë asnjëherë e theksuar, ngaqë nuk ka arsye që në bazë të rregullimit mekanik, theksi të lëvizte nga pozicioni fundor një rrokje përpara, përveçse në huazimet turke: tosk. *kafë* e geg. *káfe*. Pra, me fjalë të tjera, sipas rregullimit mekanik të theksit të shqipes, theksi i fjalës lëviz nga rrokja tejfundore në rrokjen parafundore ose nga balli i fjalës në drejtim të mbaresës e, jo në drejtim të kundërt: sll. *lópata* e shq. *lopátë* (Topalli 1995: 253–254).

## 2. Theksi i fjalisë

Përpos këtyre, në pjesën e dytë të studimit për *Theksin*, Topalli ka shtruar edhe çështjen e theksit dinamik në fjali/ në ligjërimin e lidhur, duke i lidhur dukuritë me fonetikën sintaksore a me sand’hin. Psh., në sistemin zanor, lëvizja e theksit tek emrat *miell, diell, qiell* etj., të cilët kanë dhënë trajta me diftong: *mjëll, djëll, qjëll*, duke zhvendosur theksin në elementin e dytë të togut zanor; ose, mund të diskutohet edhe lidhur me pohimin e Topallit se, përemrat pronorë të vetës I dhe II njëjës, *im*< \**imë*, *yt*< \**ytë*, *tat*< \**tatë*, kanë tjetër shpjegim.

Sipas autorit, kjo është një rënie e hershme që ka përfunduar para fillimeve të shqipes së shkruar (*Ati em, mishtë tat, shpirtit tit*) dhe lidhet me fonetikën sintaksore, për shkak të pozicionit të tyre para emrave të farefisnisë *im atë, yt bir*. Kështu, zanorja *-ë* ka formuar dikur një sintagmë anapestimë *atë, ytë bir* (Topalli 1995b: 429–431) – *ë*-ja ka ndërhyrë ndërmjet dy bashkëtingëlloreve për të mënjanuar takimin e tyre; pastaj, zanoret e tjera anaptitike *-i*, por edhe *-e, -a*.

Përpos këtyre, autori ka trajtuar edhe dukuri të tjera që lidhen me dinamizmin e theksit të gjuhës shqipe, siç janë: haplologjia, hiati (ndërrhyrja e bashkëtingëlloreve *-j-*, *-v-*, *-h-*) etj., por duke u marrë më fort me aspektin etimologjik e gramatikor, sesa fonologjik. Për më tepër, autori ka bërë diferencimin se kur zhvillimet gjuhësore janë në sand'hi e, kur janë një përzierje trajtash me burime dialektore: pra, lidhet me sand'hin, nëse pjesorja e mbipërbërë e foljes *kam* (trajta *pasë*) në gegërishten, për shkak të mungesës së theksimit, del me zanore të shkurtër *ka pās ardhë*, *ka pās kenë* (por, del me zanore të gjatë, meqë e ka bjerrë zanoren *-ë*: *kam pās*); kurse, është veçori e dialekteve, nëse në toskërishten, ku pjesorja del në pozicion të patheksuar dhe përdoret trajta e shkurtër me burim gegë *ka pasë shkuar* (por, përdoret trajta e zgjeruar kur pjesorja është e theksuar *ka pasur*) (Topalli 1995a: 367–368).

### **Përfundimi**

Rrugën e hapur nga Demiraj për çështjen e theksit e ndoqi edhe Topalli. Për theksimin e fjalëve, sipas Topallit, gjuha shqipe ka ndjekur një rrugë të veçantë, të ndryshme nga gjuhët e tjera të familjes indoevropiane. Kjo vihet re te theksi i fuqishëm dinamik, në karakterin e fiksuar të tij në paradigmen e lakimit dhe në prirjen e theksimit parafundor të fjalës. Veç kësaj, theksi dinamik, si veçori e lashtë në shqipen, në kontekstin indoevropian përkon me gjermanishten, keltishten, balto-sllavishten, armenishten etj., të cilat kanë një theks të tillë.

Te theksi i fjalisë, dukuritë fonetike në ligjërimin e lidhur më tepër i kanë prekur zanoret, duke shkaktuar kështu: zhvendosjen e theksit në drejtim të mbaresës për të krijuar tema trokaike, ndryshimi i kuantitetit, rëniet e tingujve, shtesat e tingujve etj. Të gjitha këto dukuri të zhvilluara në kushtet e sand'hit dëshmojnë rolin e madh që ka luajtur në shqipen theksi i fjalisë, për të ndryshuar formën fonetike të shumë fjalëve.

Në fund, autori ka paraqitur edhe një mori të dhënash se si theksi dinamik i fjalisë lidhet me krijimin e fjalëve të reja ose fjalëformimin me përngjitje (aglutinacioni), si formime të reja e që e vendosin theksin mbi elementin e dytë formues, te emrat: farefīs, zotrote (nga *zotëria jote*); mbiemrat: i paemër, i pafaj; numërorët: njëmbëdhjetë, njëzet; përemrat: kushdo, dikush; foljet: vërej, bëzaj; ndajfoljet: qatje (nga *qe atje*), pikësëpari; parafjalët: nëpër (nga *në për*), përveç; lidhëzat: posikur, gjithashtu; pjesëzat: sidomos, kushedi; pasthirrmat: prapakthehu, punambarë etj. – shumica e tyre janë formuar që në shekujt e Mesjetës.

Së fundi, evolucioni i shqipes në fushën e prozodisë, përfshin: theksimin e rrokjes në ballë të fjalës (theksin nistor), ngulitjen e tij në një rrokje të temës ku nuk janë treguesit gramatikorë dhe lëvizjen e tij mekanike për të krijuar përgjithësisht fjalë parafundore.



## Bibliografia

- Beekes, Robert S. P. (2011). *Comparative Indo-European linguistics: an introduction*. John Benjamins Publishing Co.: Amsterdam.
- Bokshi, Besim (2005). *Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes*. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës: Prishtinë.
- Bokshi, Besim (2008). *Prapavendosja e nyjës në gjuhët ballkanike*. Akademia e Shkencave e Shqipërisë: Tiranë.
- Bokshi, Besim (2010). Për theksin e shqipes dhe për lëvizjen e hershme të tij. *Çështje të studimeve diakronike të shqipes*. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës: Prishtinë.
- Çabej, Eqrem (1980). *Hyrje në gjuhësinë krahasimtare-historike*. Prishtinë.
- Çabej, Eqrem (1987). *Studime gjuhësore III*. Rilindja: Prishtinë.
- Demiraj, Shaban (1988). *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*. Rilindja: Prishtinë.
- Demiraj, Shaban (1989). *Gjuha shqipe dhe historia e saj*. Rilindja: Prishtinë.
- Dodi, Anastas (1970). *Fonetika e gjuhës së sotme shqipe*. Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës: Prishtinë.
- Dodi, Anastas (2004). *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*. Akademia e Shkencave e Shqipërisë: Tiranë.
- Ismajli, Rexhep (1987). *Artikuj mbi gjuhën shqipe*. Rilindja: Prishtinë.
- Quiles, Carlos (2007). *A grammar of modern Indo-European*. Indo-European Language Association: Spain.
- Sawicka, Irena (1988). Theksi në shqipen. *Seminari 13 Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare*. Universiteti i Prishtinës: Prishtinë (113–117).
- Topalli, Kolec (1995a). *Theksi në gjuhën shqipe*. Shtëpia Botuese Enciklopedike: Tiranë.
- Topalli, Kolec (1995b). Rënia e zanores së rrëgjuar fundore sipas të dhënave të “Mesharit” të Gjon Buzukut. *Seminari XVII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare*. Eurorilindja: Tiranë (427–431).
- Topalli, Kolec (2001). Gjurmime të reja në sistemin zanor të gjuhës shqipe. *Seminari 19 Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare*. Universiteti i Prishtinës: Prishtinë (389–399).
- Topalli, Kolec (2012). Shtresimi i huazimeve nga gjuhët ballkanike në një fjalor etimologjik. *Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit*. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës: Prishtinë (175–183).